

# Rekomandimet nga Barometri i Reformave Evropiane

prill 2025



**Titulli i publikimit:**

Rekomandimet nga Barometri i Reformave Evropiane – prill 2025

**Publikuar nga:**

Grupi për Studime Juridike dhe Politike (GLPS)  
Instituti i Kosovës për Politika Evropiane (EPIK)

**Dizajni grafik:**

2vo

Prishtinë, prill 2025

Ky raport është hartuar me mbështetjen e Ambasadës së Holandës në Kosovë. Përmbajtja e tij është përgjegjësia e vetme e Grupit për Studime Politike dhe Juridike dhe Institutit të Kosovës për Politikën Evropiane dhe në asnjë formë nuk pasqyron pikëpamjet e Ambasadës së Holandës në Kosovë.



Group for Legal  
and Political  
Studies

epik.

NL Netherlands

# Rekomandimet nga Barometri i Reformave Evropiane

## Përmbajtja

Hyrje	4
Arritjet dhe Sfidat e Kornizës Planifikuese të Qeverisë në Fushën e Integritit Evropian	5
Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve (MFPT)	5
Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës (MMPHI)	5
Ministria e Punëve të Brendshme (MPB)	6
Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural (MBPZHR)	8
Ministria e Drejtësisë (MD)	8
Ministria e Ekonomisë (ME)	9
Zyra e Kryeministrit (ZKM)	10
Ministria e Shëndetësisë (MSH)	
Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit (MASHTI)	11
Ministria për Komunitete dhe Kthim (MKK)	11
Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë (MINT)	12
Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës (MPJD)	13
Ministria e Kulturës së Rinisë dhe Sportit (MKRS)	
Ministria e Zhvillimit Rajonal (MZHR)	13
Përfundime dhe Rekomandime	13
Rekomandime për forcimin e kuadrit të planifikimit dhe zbatimit	16

# Hyrje

Gjatë viteve 2023 dhe 2024, Grupi për Studime Juridike dhe Politike (GLPS) dhe Instituti i Kosovës për Politika Evropiane të Kosovës, me mbështetjen e Ambasadës së Mbretërisë së Holandës në Kosovë, publikuan dy Barometra Vjetorë të Reformave Evropiane. Qëllimi i këtyre barometrave ishte të ofrojnë një vlerësim të pavarur, sistematik dhe gjithëpërfshirës të performancës së Qeverisë në zbatimin e reformave të kërkuara nga Bashkimi Evropian.

Në këtë kontekst, ky dokument synon të nxjerrë mësim nga dy edicionet e Barometrit dhe të ofrojë gjetjet kryesore si dhe rekomandime për të ardhmen.

## Gjetjet Kryesore:

- Ndërsa shumica e ministrive kanë treguar përmirësime në planifikim dhe zbatim, sfidat strukturore të thella vazhdojnë të jenë të pranishme.
- Ekziston një mospërputhje e përsëritur ndërmjet kuadrove të planifikimit qeveritar dhe obligimeve që burojnë nga agjenda evropiane. Në disa raste, më pak se 30% e masave të kërkuara nga BE-ja janë të integruara në planifikimin ministror.
- Mungesat në zbatim mbeten të mëdha, me disa ministri që realizojnë më pak se 40% të veprimeve të planifikuara, pavarësisht kompleksitetit të lartë të dokumenteve strategjike.
- Disa ministri, veçanërisht Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve (MFPT), kanë shënuar përparim të dukshëm, duke përmirësuar përputhshmërinë me obligimet e BE-së nga 31% në vitin 2023 në 87% në vitin 2024, duke ruajtur një nivel të qëndrueshëm të zbatimit.
- Në të kundërt, disa ministri (p.sh. Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit; Ministria e Zhvillimit Rajonal) kanë treguar angazhim minimal ose performancë të dobët, qoftë përmes mungesës së masave të planifikuara apo zbatimit të dobët të tyre.
- Barometri gjithashtu nxjerr në pah luhatshmërinë e progresit të reformave, me disa ministri që kanë bërë hapa prapa nga një vit në tjetrin për shkak të mungesës së vazhdimësisë institucionale.

## Rekomandimet Kryesore:

- Të forcohet përputhshmëria strategjike ndërmjet dokumenteve kombëtare të planifikimit dhe agjendës së integritimit evropian.
- Të investohet në ndërtimin e kapaciteteve institucionale për të siguruar zbatimin efektiv të masave të ndërlikuara të reformës.
- Të krijohen mekanizma të fuqishëm për monitorim dhe vlerësim në të gjitha ministritë përkatëse.
- Të institucionalizohet integrimi evropian si një prioritet ndërsektorial, duke siguruar që reformat të jenë pjesë përbërëse e proceseve thelbësore të planifikimit.
- Të përmirësohet koordinimi ndërministror, veçanërisht me Zyrën e Kryeministrit, për të rritur koherencën dhe përgjegjshmërinë.
- Të ofrohet mbështetje e synuar për ministritë me performancë të dobët, përmes mentorimit, asistencës teknike dhe udhëzimeve në hartimin e politikave.

# Arritjet dhe sfidat e Kornizës Planifikuese të Qeverisë në Fushën e Integritimit Evropian

## Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve (MFPT)

Në kuadër të barometrit të vitit 2023 Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve (MFPT) ka treguar performancë të mirë në përmbushjen e reformave evropiane. Në total ajo ka fituar 53 pikë. Korniza e saj planifikuese për përmbushjen e reformave evropiane është karakterizuar me masa mjaft komplekse. Edhe në aspektin e zbatimit të masave të parapara ministria tregoj performancë të mirë duke siguruar zbatim të 63% të masave të parapara në kuadër të PKIE-së. Sidoqoftë, nga ana tjetër është vërejtur se ekziston një mosharmonizim i ndjeshëm në mes planifikimit të masave nga ana e MFPT-së në kuadër të kornizës planifikuese të Qeverisë dhe obligimeve të MFPT-së në kuadër të agjendës evropiane. Vetëm 31% e obligimeve në kuadër të agjendës evropiane ishin adresuar në planifikimin e MFPT-së. Po ashtu gjatë vitit 2023 Raporti i BE-së nuk ka evidentuar progres më të mirë krahasuar me vitin e kaluar.

Në kuadër të barometrit të vitit 2024 MFPT ka treguar performancë më të mirë në përmbushjen e reformave evropiane se në vitin 2023. Në total ajo fitoj 83 pikë. Korniza e saj planifikuese për përmbushjen e reformave evropiane u karakterizua me masa mjaft komplekse dhe sikur në vitin 2023 MFPT siguroj edhe në vitin 2024 një zbatim të konsoliduar të masave të planifikuara prej 65%. Kësaj radhe MFPT siguroj edhe harmonizim të konsoliduar ndërmjet kornizës planifikuese të qeverisë me obligimet në kuadër të agjendës evropiane prej 87%. Këtë performancë të mirë njohu edhe Komisioni Evropian brenda raportit të vjet vjetor me ç'rast përpjekjet e MFPT-së u vlerësuan pozitivisht në veçanti në kuadër të kapitullit 19: politikat sociale dhe punësimi, si dhe kapitullit 29: bashkimi doganor.

Nga dy raunde të barometrit të reformave evropiane mund të konkludojmë se MFPT ka arritur një stad të avancuar të planifikimit dhe zbatimit të obligimeve evropiane. Poashtu në vitin e fundit të barometrit MFPT shënoj progres të ndjeshëm edhe në harmonizimin e kornizës planifikuese dhe detyrimeve që rrjedhin nga procesi i integritimit evropian. Tani ngelet që ministria të ruaj trendin pozitiv të reformave evropiane të cilat vlerësohen rregullisht nga ana e Komisionit Evropian.

## Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës (MMPHI)

Në kuadër të barometrit të vitit 2023 Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës (MMPHI) tregoj performancë të mirë në përmbushjen e reformave evropiane. Në total ajo fitoj 64 pikë. Korniza e saj planifikuese për përmbushjen e reformave evropiane është

karakterizuar me masa mjaft komplekse. Edhe në aspektin e zbatimit të masave të parapara MMPHI tregoj performancë të mirë duke siguruar zbatim të 72% të masave të parapara në kuadër të Programit Kombëtar për Integrim Evropian. Sidoqoftë, nga ana tjetër është vërejtur se ekziston një mosharmonizim i ndjeshëm në mes planifikimit të masave nga ana e MMPHI-së në kuadër të kornizës planifikuese të Qeverisë dhe obligimeve të saja në kuadër të agjendës evropiane. 49% e detyrimeve që rrjedhin nga procesi i integritimit në BE janë adresuar në kuadër të kornizës planifikuese të MMPHI-së. Po ashtu gjatë vitit 2023 Raporti i BE-së nuk ka evidentuar progres më të mirë krahasuar me vitin e kaluar.

Në kuadër të barometrit të vitit 2024 MMPHI përsëri tregoj performancë të mirë në përmbushjen e reformave evropiane. Në total ajo fitoj 68 pikë. Korniza e saj planifikuese për përmbushjen e reformave evropiane u karakterizua me masa mjaft komplekse. 92% e masave të ministrisë u vlerësuan si masa komplekse. Dhe ndryshe nga viti i kaluar gjatë vitit 2024 Komisioni Evropian vlerësoj pozitivisht përpjekjet e ministrisë, në veçanti në kapitullin 14: politikat e transportit. Përkundër këtij progresi MMPHI në vitin 2024 u ballafaqua përsëri me sfida në harmonizimin e kornizës planifikuese të ministrisë me detyrimet që rrjedhin nga procesi i integritimit evropian. Po ashtu, ministria në vitin 2024 shënoj një shkallë më të ultë të zbatimit të obligimeve në kuadër të PKIE-së prej 48%, krahasuar me 73% sa ishte në vitin 2023.

Nga dy raunde të barometrit të reformave evropiane mund të konkludojmë se MMPHI ka arritur një stad të avancuar të planifikimit të obligimeve evropiane dhe një stad të konsoliduar të zbatimit të masave të parapara në kuadër të PKIE-së. Sidoqoftë, sfida ngelet harmonizimi më i mirë ndërmjet kornizës planifikuese dhe detyrimeve që rrjedhin nga procesi i integritimit evropian, si dhe ruajtja e trendit pozitiv të reformave evropiane të cilat vlerësohen rregullisht nga ana e Komisionit Evropian.

### Ministria e Punëve të Brendshme (MPB)

Në kuadër të barometrit të vitit 2023 Ministria e Punëve të Brendshme (MPB) tregoj performancë të mirë në përmbushjen e reformave evropiane. Në total ajo fitoj 56 pikë. Korniza e saj planifikuese për përmbushjen e reformave evropiane u karakterizua me masa mjaft komplekse. Edhe në aspektin e zbatimit MPB tregoj performancë të mirë duke siguruar zbatim të 77% të masave të parapara në kuadër të PKIE-së. Sidoqoftë, nga ana tjetër është vërejtur se ekziston një mosharmonizim i ndjeshëm në mes planifikimit të masave nga ana e ministrisë në kuadër të kornizës planifikuese të Qeverisë dhe obligimeve të saja në kuadër të agjendës evropiane. Vetëm 32% e detyrimeve që rrjedhin nga procesi i integritimit në BE janë adresuar në kuadër të kornizës planifikuese të ministrisë. Po ashtu gjatë vitit 2023 Raporti i BE-së nuk ka evidentuar progres më të mirë krahasuar me vitin e kaluar.

Në kuadër të barometrit të vitit 2024 MPB tregoj performancë të mirë në përmbushjen e reformave evropiane. Në total ajo fitoj 64 pikë. Korniza e saj planifikuese për përmbushjen e reformave evropiane u karakterizua me masa mjaft komplekse. 83% e masave të ministrisë

u vlerësuan si masa komplekse. Edhe në aspektin e zbatimit MPB tregoj performancë të mirë duke siguruar zbatim të 80% të masave të parapara në kuadër të PKIE-së. Po ashtu përpjekjet e ministrisë u njohën edhe nga ana e Komisionit Evropian i cili vlerësoj pozitivisht performancën e ministrisë gjatë vitit 2024. Sidoqoftë ministria përsëri u ballafaqua me sfida në harmonizimin e kornizës planifikuese të ministrisë me detyrimet që rrjedhin nga procesi i integritit evropian, pasi që vetëm 14% e obligimeve që dalin nga agjenda evropiane u adresuan në kuadër të planifikimit të MPB-së.

Nga dy raunde të barometrit të reformave evropiane mund të konkludojmë se MPB ka arritur një stad të avancuar të planifikimit të obligimeve evropiane dhe një stad të konsoliduar të zbatimit të masave të parapara në kuadër të PKIE-së. Sidoqoftë, sfida ngelet harmonizimi më i mirë ndërmjet kornizës planifikuese dhe detyrimeve që rrjedhin nga procesi i integritit evropian, si dhe ruajtja e trendit pozitiv të reformave evropiane të cilat vlerësohen rregullisht nga ana e Komisionit Evropian.

## Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural (MBPZHR)

Në kuadër të barometrit të vitit 2023 Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural (MBPZHR) tregoj performancë të mirë në përmbushjen e reformave evropiane. Në total ajo fitoj 60 pikë. Korniza e saj planifikuese për përmbushjen e reformave evropiane u karakterizua me masa mjaft komplekse. Po ashtu, MBPZHR ka siguruar një zbatim të konsoliduar të masave të parapara në kuadër të vitit 2023 prej 71%. Sidoqoftë, nga ana tjetër vërehet se ekziston një mosharmonizim i ndjeshëm në mes planifikimit të masave nga ana e MBPZHR-së në kuadër të kornizës planifikuese të Qeverisë dhe obligimeve të ministrisë në kuadër të agjendës evropiane. Vetëm 24% e detyrimeve që rrjedhin nga procesi i integritimit në BE janë adresuar në kuadër të kornizës planifikuese të ministrisë. Po ashtu gjatë vitit 2023 Raporti i BE-së nuk ka evidentuar progres më të mirë krahasuar me vitin e kaluar.

Në kuadër të barometrit të vitit 2024 MBPZHR tregoj performancë të mirë në përmbushjen e reformave evropiane. Në total ajo fitoj 61 pikë. Korniza e saj e planifikimit u karakterizua me masa të kompleksitetit të lartë, ndonëse ajo u zbatua në shkallën prej vetëm 38%. Njëkohësisht ministria u ballafaqua me sfida në harmonizimin e kornizës planifikuese të ministrisë me detyrimet që rrjedhin nga procesi i integritimit evropian, pasi që vetëm 31% e obligimeve që dalin nga agjenda evropiane u adresuan në kuadër të planifikimit të ministrisë. Sidoqoftë, përpjekjet e saja gjatë vitit 2024 u vlerësuan pozitivisht nga ana e Komisionit Evropian në kapitullin 11: bujqësia dhe zhvillimi rural dhe kapitulli 12: siguria ushqimore, politika veterinare dhe fitosanitare.

Nga dy raundet të barometrit të reformave evropiane mund të konkludojmë se MBPZHR ka arritur një stad të avancuar të planifikimit të obligimeve evropiane dhe një stad të konsoliduar të zbatimit të masave të parapara në kuadër të PKIE-së. Sidoqoftë, sfida ngelet harmonizimi më i mirë ndërmjet kornizës planifikuese dhe detyrimeve që rrjedhin nga procesi i integritimit evropian, si dhe ruajtja e trendit pozitiv të reformave evropiane të cilat vlerësohen rregullisht nga ana e Komisionit Evropian.

## Ministria e Drejtësisë (MD)

Në kuadër të barometrit të vitit 2023 Ministria e Drejtësisë (MD) tregoj performancë të mirë në përmbushjen e reformave evropiane. Në total ajo fitoj 53 pikë. Në kuadër të kornizës planifikuese të qeverisë në fushën e integritimit Evropian masat e MD-së u karakterizuan me një planifikim të masave të kompleksiteti shumë të lartë. Po ashtu, MD siguroj një zbatim të konsoliduar të masave të parapara prej 67%. Sidoqoftë, nga ana tjetër MD nuk ka arritur të siguroj harmonizim në mes masave të planifikuara dhe obligimeve në kuadër të agjendës evropiane. Po ashtu gjatë vitit 2023 Raporti i BE-së nuk evidentoj progres më të mirë krahasuar me vitin e kaluar.

Në kuadër të barometrit të vitit 2024 MD tregoj performancë të mirë në përmbushjen e reformave evropiane. Në total ajo fitoj 57 pikë. Në kuadrin e planifikimit të qeverisë në fushën e integritimit evropian, MD

u karakterizua me planifikim të masave me kompleksitet shumë të lartë. Po kështu, MD ka siguruar një zbatim të konsoliduar të masave të planifikuara për vitin 2024 prej 63%. Nga ana tjetër, kuadri i planifikimit të politikave të MD-së u karakterizua edhe në vitin 2024 me mospërputhje ndërmjet kornizës së planifikimit të politikave dhe detyrimeve që rrjedhin nga procesi i integritimit në BE. Po ashtu gjatë vitit 2024 Raporti i BE-së nuk evidentoi progres më të mirë krahasuar me vitin e kaluar.

Nga dy raunde të barometrit të reformave evropiane mund të konkludojmë se MD ka arritur një stad të avancuar të planifikimit të obligimeve evropiane dhe një stad të konsoliduar të zbatimit të masave të parapara në kuadër të PKIE-së. Sidoqoftë, sfidë ngelet harmonizimi më i mirë ndërmjet kornizës planifikuese dhe detyrimeve që rrjedhin nga procesi i integritimit evropian, si dhe ruajtja e trendit pozitiv të reformave evropiane të cilat vlerësohen rregullisht nga ana e Komisionit Evropian.

### Ministria e Ekonomisë (ME)

Në kuadër të barometrit të vitit 2023 Ministria e Ekonomisë (ME) tregoi performancë të mirë në përmbushjen e reformave evropiane. Në total ajo fitoi 64 pikë. Në kuadër të kornizës planifikuese të qeverisë në fushën e integritimit Evropian masat e ME-së u karakterizuan me një planifikim të masave të kompleksiteti të lartë dhe përpjekjet e saja për reforma u vlerësuan pozitivisht edhe në kuadër të raportit të Komisionit Evropian 2023. Nga ana tjetër, planifikimi i masave të ME-së në kuadër të kornizës planifikuese të qeverisë u karakterizua me një ndërlidhje të kufizuar në mes obligimeve në kuadër të agjendës evropiane dhe masave të planifikuara. Po ashtu, ME arriti vetëm progres të kufizuar në zbatimin e masave të planifikuara, pasi që siguroi zbatimin e 46% të masave të parapara në kuadër të PKIE-së.

Në kuadër të barometrit të vitit 2024 MD tregoi performancë të mirë në përmbushjen e reformave evropiane. Në total ajo fitoi 54.5 pikë. Kuadri i planifikimit të ME-së u karakterizua me masa me kompleksitet të lartë, ndonëse ME siguroi vetëm zbatimin e kufizuar të tyre. Nga ana tjetër, masat e ME-së brenda kuadrit të planifikimit të qeverisë u karakterizuan me një përafrim të kufizuar me detyrimet që rrjedhin nga procesi i integritimit në BE. 42% e detyrimeve që rrjedhin nga procesi i integritimit në BE u adresuan në kuadër të kornizës planifikuese të ME-së.

Nga dy raunde të barometrit të reformave evropiane mund të konkludojmë se ME ka arritur një stad të avancuar të planifikimit të obligimeve evropiane dhe një stad të kufizuar të zbatimit të masave të parapara në kuadër të PKIE-së. Në këtë drejtim sfidë ngelet harmonizimi më i mirë ndërmjet kornizës planifikuese dhe detyrimeve që rrjedhin nga procesi i integritimit evropian, si dhe ruajtja e trendit pozitiv të reformave evropiane të cilat vlerësohen rregullisht nga ana e Komisionit Evropian.

## Zyra e Kryeministrit (ZKM)

Në kuadër të barometrit të vitit 2023 Zyra e Kryeministrit (ZKM) tregoj performancë të kufizuar në përmbushjen e reformave evropiane. Në total ajo fitoj 39 pikë. Në kuadër të kornizës planifikuese të qeverisë në fushën e integritimit Evropian ZKM karakterizohet me një planifikim të masave të kompleksiteti të ndjeshëm dhe njëkohësisht ZKM ka siguruar shkallë të lartë të zbatimit të kornizës së saj planifikuese prej 71%. Nga ana tjetër, korniza planifikuese e ZKM-së nuk reflekton obligimet që burojnë nga procesi integruese.

Në kuadër të barometrit të vitit 2024 ZKM tregoj performancë të kufizuar në përmbushjen e reformave evropiane. Në total ajo fitoj 48 pikë. Korniza e saj e planifikimit u karakterizua me masa të kompleksitetit të konsiderueshëm, por nga ana tjetër ajo nuk adresoj një pjesë të obligimeve që rrjedhin nga agjenda evropiane. Njëkohësisht, ZKM tregoj performancë të kufizuar në zbatimin e masave të paraparë për vitin 2024 pasi që zbatoj vetëm 40% të tyre. Sidoqoftë, përpjekjet e saja gjatë vitit 2024 u vlerësuan pozitivisht nga ana e Komisionit Evropian në fushën e reformës së administratës publike, me theks të veçantë në parandalimin dhe zvogëlimin e barrës administrative.

Nga dy raunde të barometrit të reformave evropiane mund të konkludojmë se ZKM ka arritur një stad të mirë të planifikimit të obligimeve evropiane dhe një stad të kufizuar të zbatimit të masave të parapara në kuadër të PKIE-së. Në këtë drejtim sfidë ngelet harmonizimi më i mirë ndërmjet kornizës planifikuese dhe detyrimeve që rrjedhin nga procesi i integritimit evropian, si dhe ruajtja e trendit pozitiv të reformave evropiane të cilat vlerësohen rregullisht nga ana e Komisionit Evropian.

Ministria e Shëndetësisë (MSH)

Në kuadër të barometrit të vitit 2023 Ministria e Shëndetësisë (MSH) tregoj performancë të kufizuar në përmbushjen e reformave evropiane. Në total ajo fitoj 45 pikë. Në kuadër të kornizës planifikuese të qeverisë në fushën e integritimit Evropian MSH u karakterizua me një planifikim të masave mjaft komplekse. Sidoqoftë, nga ana tjetër është evidentuar se ekziston një mosharmonizim i ndjeshëm në mes planifikimit të masave nga ana e MSH-së në kuadër të kornizës planifikuese të Qeverisë dhe obligimeve të MSH-së në kuadër të agjendës evropiane. Njëkohësisht MSH siguroj vetëm zbatim të kufizuar të masave të planifikuara gjatë vitit 2023. Ndonëse raporti i BE-së vlerësoj përpjekjet e MSH-së për të avancuar brenda kapitullit 28 – Mbrojtja e shëndetit dhe konsumatorit, ai po ashtu ka konfirmuar se nuk ka pasur ndryshim krahasuar me vitin e kaluar.

Në kuadër të barometrit të vitit 2023 MSH tregoj performancë të kufizuar në përmbushjen e reformave evropiane. Në total ajo fitoj 48 pikë. Korniza e saj e planifikimit u karakterizua me masa të kompleksitetit të lartë, por nga ana tjetër ajo nuk adresoj një pjesë të konsiderueshme të obligimeve që rrjedhin nga agjenda evropiane. Njëkohësisht, MSH tregoj performancë të kufizuar në zbatimin e masave të paraparë për vitin 2024 pasi që vetëm 33% e masave të parapara për vitin 2024 janë zbatuar nga ministria.

Nga dy raunde të barometrit të reformave evropiane mund të konkludojmë se MSH ka arritur një stad të mirë të planifikimit të obligimeve evropiane dhe një stad të kufizuar të zbatimit të masave të parapara në kuadër të PKIE-së. Në këtë drejtim sfidë ngelet harmonizimi më i mirë ndërmjet kornizës planifikuese dhe detyrimeve që rrjedhin nga procesi i integritit evropian, si dhe ruajtja e trendit pozitiv të reformave evropiane të cilat vlerësohen rregullisht nga ana e Komisionit Evropian.

### Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit (MASHTI)

Në kuadër të barometrit të vitit 2023 Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Infrastrukturës (MASHTI) tregoj performancë të mirë në përmbushjen e reformave evropiane. Në total ajo fitoj 60 pikë. Shumica e masave planifikuese për vitin 2023 ishin komplekse dhe MASHTI arriti një shkallë të konsoliduar të zbatimit të masave të parapara në kuadër të procesit integruar. Njëkohësisht, në raportin e vitit 2023 KE-ja vlerësoj pozitivisht përparimin e bërë në Kapitullin 25 – Shkenca dhe hulumtimi. Në anën tjetër, MASHTI u karakterizua me një shkallë të kufizuar të harmonizimit të masave planifikuese me kërkesat e integritit evropian pasi që vetëm 33% e obligimeve në kuadër të agjendës evropiane janë të adresuara nga ana planifikimi i MASHTI-it.

Në kuadër të barometrit të vitit 2024 MASHTI tregoj performancë të kufizuar në përmbushjen e reformave evropiane. Në total ajo fitoj 44 pikë. Shumica e masave planifikuese për vitin 2024 ishin komplekse dhe MASHTI arriti një shkallë të konsoliduar të zbatimit të masave të parapara në kuadër të procesit integruar prej 61%. Sidoqoftë, MASHTI vazhdoj të sfidohet nga një shkallë e kufizuar e harmonizimit të masave planifikuese me kërkesat e integritit evropian. Po ashtu ndryshe nga viti 2023 gjatë vitit 2024 MASHTI nuk arriti të mirëmbaj trendin e reformave të treguar një vit më parë në kuadër të raportit vjetor të KE-së.

Nga dy raunde të barometrit të reformave evropiane mund të konkludojmë se MASHTI ka arritur një stad të mirë të planifikimit të obligimeve evropiane dhe një stad të konsoliduar të zbatimit të masave të parapara në kuadër të PKIE-së. Në këtë drejtim sfidë ngelet harmonizimi më i mirë ndërmjet kornizës planifikuese dhe detyrimeve që rrjedhin nga procesi i integritit evropian, si dhe ruajtja e trendit pozitiv të reformave evropiane të cilat vlerësohen rregullisht nga ana e Komisionit Evropian.

### Ministria për Komunitete dhe Kthim (MKK)

Në kuadër të barometrit të vitit 2023 Ministria për Komunitete dhe Kthim (MKK) tregoj performancë të kufizuar në përmbushjen e reformave evropiane. Në total ajo fitoj 46 pikë. Ndonëse masat e MKK-së në procesin integruar u karakterizuan me kompleksitet të kufizuar, MKK siguroj një shkallë të lartë të zbatimit të kornizës planifikuese në

fushën e integritit evropian. Nga ana tjetër, MKK nuk arriti të siguroj një harmonizim më të mirë në mes kornizës planifikuese dhe obligimeve në kuadër të agjendës evropiane.

Në kuadër të barometrit të vitit 2024 MKK tregoj performancë të kufizuar në përmbushjen e reformave evropiane. Në total ajo fitoj 42 pikë. Masat e MKK-së në procesin e integritit u karakterizuan nga kompleksiteti i kufizuar dhe mospërputhja ndërmjet kornizës së planifikimit të politikave dhe detyrimeve që rrjedhin nga agjenda e BE-së. Megjithatë, MKK siguroj një shkallë të konsoliduar të zbatimit të masave të parapara në vitin 2024.

Nga dyraundet të barometrit të reformave evropiane mund të konkludojmë se MKK ka arritur një stad të kufizuar të planifikimit të obligimeve evropiane dhe një stad të konsoliduar të zbatimit të masave të parapara në kuadër të PKIE-së. Në këtë drejtim sfidë ngelet harmonizimi më i mirë ndërmjet kornizës planifikuese dhe detyrimeve që rrjedhin nga procesi i integritit evropian, si dhe ruajtja e trendit pozitiv të reformave evropiane të cilat vlerësohen rregullisht nga ana e Komisionit Evropian.

### Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë (MINT)

Në kuadër të barometrit të vitit 2023 Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë (MINT) tregoj performancë të mirë në përmbushjen e reformave evropiane. Në total ajo fitoj 56 pikë. MINT bart përgjegjësi të madhe në kuadër të procesit integruar. MINT është përgjegjëse për njërën nga pjesët më të vështira të zbatimit të legjislacionit evropian. Rrjedhimisht MINT në kuadër të kornizës planifikuese të qeverisë në fushën e integritit evropian karakterizohet me numër të madh të masave komplekse. Njëkohësisht, gjatë vitit 2023 MINT siguroj një zbatim të konsoliduar të kornizës planifikuese dhe këtë progres ka njohur edhe Komisioni Evropian në kuadër të raportit vjetor për Kosovën. Sidoqoftë, MINT nuk ka arritur të siguroj një ndërlidhje më efektive ndërmjet kornizës së saj planifikuese dhe obligimet në kuadër të agjendës evropiane.

Në kuadër të barometrit të vitit 2024 MINT tregoj performancë të kufizuar në përmbushjen e reformave evropiane. Në total ajo fitoj 34 pikë. Korniza e saj e planifikimit u karakterizua me masa të kompleksitetit të konsiderueshëm, por nga ana tjetër ajo nuk adresoj një pjesë të konsiderueshme të obligimeve që rrjedhin nga agjenda evropiane. Njëkohësisht, MINT tregoj performancë të kufizuar në zbatimin e masave të parapara për vitin 2024.

Nga dyraundet të barometrit të reformave evropiane mund të konkludojmë se MINT ka arritur një stad të konsoliduar të planifikimit të obligimeve evropiane dhe një stad të kufizuar të zbatimit të masave të parapara në kuadër të PKIE-së. Në këtë drejtim sfidë ngelet harmonizimi më i mirë ndërmjet kornizës planifikuese dhe detyrimeve që rrjedhin nga procesi i integritit evropian, si dhe ruajtja e trendit pozitiv të reformave evropiane të cilat vlerësohen rregullisht nga ana e Komisionit Evropian.

## Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës (MPJD)

Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës (MPJD) nuk ishte pjesë e barometrit për vitin 2023. Gjatë vitit 2024 MPJD tregoj performancë të kufizuar në përmbushjen e reformave evropiane. Në total ajo fitoj 30 pikë. Shumica e masave planifikuese për vitin 2024 ishin komplekse dhe MPJD arriti një shkallë të konsoliduar të zbatimit të masave të parapara në kuadër të procesit integruar. E vetmja gjë që penalizoj MPJD është mos adresimi i rekomandimit të KE-së për fillimin e hartimit të politikës humanitare dhe zhvillimore të jashtme të Kosovës. Rrjedhimisht me shumë pak angazhim MPJD mund të siguroj vlerësim më të mirë në kuadër të barometrit.

## Ministria e Kulturës së Rinisë dhe Sportit (MKRS)

Në kuadër të barometrit të vitit 2023 Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit (MKRS) tregoj performancë të kufizuar në përmbushjen e reformave evropiane. Në total ajo fitoj 36 pikë. Ndonëse korniza planifikuese e MKRS-së ishte mjaft ambicioze ajo vuajti nga niveli i ultë i zbatimit, si dhe mosharmonizimi ndërmjet masave të planifikuara dhe obligimeve në kuadër të agjendës evropiane.

Në kuadër të barometrit të vitit 2024 MKRS tregoj përsëri performancë të kufizuar në përmbushjen e reformave evropiane. Në total ajo fitoj 25 pikë. Edhe pse korniza planifikuese e MKRS-së karakterizohej nga masat e kompleksitetit të lartë, ajo vuante nga përafrimi i dobët me detyrimet që rrjedhin nga agjenda e BE-së dhe shkalla e ultë e zbatimit të masave në kuadër të PKIE-së.

Nga dy raunde të barometrit të reformave evropiane mund të konkludojmë se ndonëse MKRS ka arritur një stad të kufizuar të planifikimit të obligimeve evropiane, sfidë ngelet shkalla e zbatimit të masave të parapara në kuadër të PKIE-së, harmonizimi më i mirë ndërmjet kornizës planifikuese dhe detyrimeve që rrjedhin nga procesi i integritimit evropian, si dhe ruajtja e trendit pozitiv të reformave evropiane të cilat vlerësohen rregullisht nga ana e Komisionit Evropian.

## Ministria e Zhvillimit Rajonal (MZHR)

Ministria e Zhvillimit Rajonal (MZHR) nuk ishte pjesë e barometrit për vitin 2023. Në kuadër të barometrit për vitin 2024 ajo mori 0 pikë pasi që përkundër obligimeve në procesin integruar MZHR nuk kishte parapa asnjë masë në kuadër të PKIE-së.

MZHR mund të adresoj këtë çështje lehtësisht në kuadër të përgatitjes së PKIE-së së ardhshme duke siguruar se ajo do të planifikoj masat të cilat do të adresojnë këto obligime që burojnë nga procesi integruar:

- Miratimi dhe zbatimi i Strategjisë dhe Planit të Veprimit për Zhvillimin Rajonal;
- Miratimi i Ligjit për Zhvillimin Rajonal dhe paralelisht legjisllacionit përkatës zbatues;

- Forcimi i kapaciteteve institucionale dhe administrative;
- Përmirësimi i linjës së vetme të projektit, duke përfshirë indikacionet për kompletimin dhe përmbushjen e projektit;
- Përcaktimi i hapave fillestarë në funksion të përgatitjes së udhërrëfyesit të kapitullit 22.

## Përfundime dhe Rekomandime

Gjetjet nga Barometri ofrojnë një pasqyrë komplekse por edhe udhëzuese mbi përgatitjen dhe performancën institucionale të Kosovës në fushën e integritimit evropian. Ndërsa disa ministri sektoriale tregojnë shenja inkurajuese progresi, pamja e përgjithshme thekson sfida sistemike që vazhdojnë të pengojnë integrimin e plotë dhe efektiv të reformave të BE-së në strukturat qeveritare.

### Mospërputhja ndërmjet Kuadrit të Planifikimit Qeveritar dhe Agjendës së BE-së

Një sfidë e përsëritur në shumicën e ministrive është mungesa e koherencës strategjike ndërmjet planifikimit të politikave kombëtare dhe detyrimeve që burojnë nga procesi i integritimit evropian. Shumë ministri nuk arrijnë të përfshijnë plotësisht detyrat që lidhen me BE-në në kuadrin e tyre zyrtar të planifikimit, gjë që zvogëlon ndjeshëm rëndësinë dhe efektivitetin e përpjekjeve për reforma.

Ministria e Punëve të Brendshme (MPB) përfaqëson një shembull të qartë të kësaj mospërputhjeje. Në vitin 2024, vetëm 14% e detyrimeve të saj që burojnë nga agjenda e BE-së ishin adresuar në dokumentet e planifikimit, pavarësisht se kishte plane të zhvilluara mirë dhe një shkallë relativisht të lartë të zbatimit. Po ashtu, Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural (MBPZHR) adresoi vetëm 24% të detyrimeve të tilla në vitin 2023 dhe 31% në 2024, duke treguar një mospërputhje të vazhdueshme të politikave kombëtare me prioritetet e BE-së.

Në kontrast, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve (MFPT) dëshmoi se përputhshmëria është e mundur. Pas trajtimit fillestar të vetëm 31% të detyrimeve të BE-së në 2023, ministria arriti përputhshmëri mbresëlënëse prej 87% në 2024. Kjo tregon se me mekanizmat e duhur të brendshëm dhe vullnet politik, ministrinë mund të mbyllin hendekun ndërmjet planifikimit kombëtar dhe pritshmërive të BE-së.

### Zbatim i Kufizuar i Masave të Planifikuara

Një sfidë tjetër madhore ka të bëjë me ekzekutimin efektiv të reformave të planifikuara. Ndërsa disa ministri arrijnë të hartojnë masa të ndërlikuara dhe ambicioze, shpesh dështojnë në realizimin e tyre. Ky deficit zbatimi zbulon dobësi kritike në kapacitetin institucional dhe planifikimin operativ.

Për shembull, Ministria e Ekonomisë (ME) zbatoi vetëm 46% të masave të saj të planifikuara në vitin 2023, dhe performanca u përkeqësua më tej në 2024. Ngjashëm, Ministria e Shëndetësisë (MSH) arriti të zbatojë vetëm 33% të veprimeve të planifikuara në 2024, duke reflektuar bllokime të mëdha institucionale. Këto mangësi jo vetëm që ulin besueshmërinë e reformave, por ngrejnë shqetësime për kapacitetin përthithës të ministrive në menaxhimin e ndryshimeve të udhëhequra nga BE-ja.

### Kompleksitet i Lartë i Masave përkundër Kapaciteteve Institucionale

Një prirje e theksuar është rritja e kompleksitetit të reformave të planifikuara nga ministritë. Edhe pse ky kompleksitet është shpesh i nevojshëm për të përmbushur standardet e BE-së, kapacitetet institucionale për zbatimin e tyre mungojnë.

Ministria e Drejtësisë (MD), për shembull, planifikoi një numër të madh reformash komplekse, duke ruajtur norma zbatimi mbi 60% në të dy vitet. Megjithatë, ministria nuk arriti të përputhte këto reforma me detyrime specifike të BE-së, duke kufizuar ndikimin e tyre në procesin e integritimit.

Ngjashëm, Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës (MMPHI) përjetoi një rënie të madhe në performancën e zbatimit—nga 72% në vitin 2023 në vetëm 48% në 2024—pavarësisht se 92% e masave të saj ishin kategorizuar si komplekse. Kjo sugjeron se sofistikimi i planeve nuk përputhet me kapacitetet e brendshme të nevojshme për t'i zbatuar me sukses.

### Planifikim i mangët në disa Ministri

Ndërsa shumë ministri luftojnë me përputhjen dhe zbatimin, të tjera nuk angazhohen fare në mënyrë kuptimplote në procesin e planifikimit. Rasti më i theksuar është Ministria e Zhvillimit Rajonal (MZHR), e cila mori zero pikë në barometrin e vitit 2024 për shkak të mungesës të masave të planifikuara që lidhen me BE-në brenda Programit Kombëtar për Integrimin Evropian (PKIE). Kjo tregon një mungesë shqetësuese të pronësisë institucionale mbi agjendën e integritimit evropian dhe sinjalizon nevojën për masa urgjente korrigjuese.

### Mungesë Konsistence në Dinamikën e Reformave

Një shqetësim tjetër është mospërputhja në performancën reformuese ndër vite. Disa ministri që kishin performuar relativisht mirë në një cikël, dështuan të ruanin këtë ritëm në vitin pasues. Kjo tregon për mungesë të institucionalizimit të reformave dhe mbështetje në iniciativa të përkohshme apo ad-hoc.

Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit (MASHTI) ilustron këtë problem. Ajo ra nga 60 pikë në 2023 në vetëm 44 pikë në

2024, dhe Komisioni Evropian shënoi stagnimin në raportin e tij vjetor për vendin. Edhe Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit (MKRS) pësoi një rënie nga 36 në 25 pikë midis dy cikleve, duke theksuar rrezikun e kthimit mbrapa në reforma.

## Rekomandime për forcimin e kuadrit të planifikimit dhe zbatimit

### Forcimi i Planifikimit Strategjik dhe Përafrimit të Politikave

Ministritë duhet të përputhin më ngushtë kornizat e tyre politike me agjendën e integritit evropian. Kjo përfshin integrimin e detyrimeve të BE-së në dokumentet vjetore dhe afatmesme të planifikimit. Shembulli pozitiv i MFPT që përmirësoi përputhjen nga 31% në 87% për një vit ofron një model të vlefshëm për t'u ndjekur.

### Rritja e Kapaciteteve për Zbatim

Ministritë duhet të mbështeten në zhvillimin e kapaciteteve administrative, teknike dhe të burimeve njerëzore për zbatimin efektiv të reformave komplekse. Duhet ofruar mbështetje e synuar për ministritë me performancë të ulët si ME, MINT dhe MSH.

Zhvillimi i Mekanizmave të Fuqishëm të Monitorimit dhe Vlerësimit  
Ka nevojë për përmirësim të sistemeve të brendshme të monitorimit për të ndjekur progresin në kohë reale dhe për të mundësuar korrigjime të shpejta. Ministritë si MD dhe MASHTI do të përfitonin nga institucionalizimi i mjeteve të monitorimit që mund të lidhin boshllëkun midis planeve dhe rezultateve faktike.

### Institucionalizimi i Reformave të BE-së në Politikat Sektoriale

Agjenda e integritit duhet parë si pjesë thelbësore e strategjive zhvillimore sektoriale dhe jo si proces paralel. Ministritë sektoriale duhet të detyrohen të përfshijnë detyrimet e BE-së në dokumentet e tyre politike si praktikë standarde.

Sigurimi i Vazhdueshmërisë dhe Pronësisë Institucionale të Reformave  
Për të reduktuar varësinë nga stafi individual apo ciklet e shkurtra politike, ministritë duhet t'i integrojnë reformat e BE-së në proceset e tyre të brendshme të punës, përshkrimet e detyrave dhe sistemet e menaxhimit të performancës. Rënia e performancës së MASHTI dhe MKRS mes viteve 2023 dhe 2024 tregon rrezikun që vjen nga mbështetja në iniciativa të përkohshme ose planifikim të bazuar në projekte.

### Përmirësimi i Koordinimit Ndërministror

Koordinimi efektiv—veçanërisht ndërmjet ministrive sektoriale dhe Zyrës së Kryeministrit (ZKM)—është thelbësor për të siguruar koherencë, shmangie të dyfishimit dhe monitorim të përgjithshëm të zbatimit të reformave.

Vetë ZKM duhet të luajë një rol më proaktiv dhe strategjik në udhëheqje; performanca e saj në zbatim ra në 40% në vitin 2024, pavarësisht rolit të saj qendror në koordinim.

